



## MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

**Tiranë më 07.06.2017**

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës **07.06.2017** shqyrtoi relacionet e përgatitura nga Drejtoritë Teknike të ERE dhe mori vendime si më poshtë:

1. Në lidhje me fillimin e procedurave për miratimin e Draft-Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit; Marrëveshjes së Operimit në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit si dhe Marrëveshjes së Lidhjes në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit.
2. Në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Diteko“ sh.p.k, për lënien peng të aseteve që i shërbejnë aktivitetit për të cilin është licencuar e që janë objekt miratimi nga ERE, në favor të “Bankës Kombëtare Tregtare” sh.a.
3. Në lidhje me fillimin e procedurës për liçensimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
4. Në lidhje me fillimin e procedurës për liçensimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike.
5. Në lidhje me rinovimin licencës së shoqërisë “Kurum International” sh.a në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Në lidhje me miratimin e kërkesës së shoqërisë “Lengarica & Energy “ sh.p.k , për vendosje peng të aseteve në favor të Bankave: Green For Growth Southeast Europe S.A ( G G F), Oeserreeichische Entwicklungbank AG (OeEB), për efekt të marrjes së nje kredie afatgjatë.
7. Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.
8. Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017.